

UDHËZUES OPERACIONAL PËR IDENTIFIKIMIN DHE MOBILIZIMIN E KOLATERALIT NË NDËRHYRJEN E JASHTËZAKONSHME¹

¹ Për pyetje dhe komente në lidhje me këtë udhëzues, kontaktoni në adresën:
resolution@bankofalbania.org

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Kuadri i qeverisjes dhe menaxhimit të kolateralit në ndërhyrjen e jashtëzakonshme	4
2.1. Qeverisja dhe menaxhimi i kolateralit në ndërhyrjen e jashtëzakonshme	4
2.2. Aksesit i bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme në financimin në kohë normale nga banka qendrore	5
2.3. Aksesit i bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme në financimin e siguruar nëpërmjet tregjeve private	5
3. Identifikimi i aktiveve që do të përdoren si kolateral në ndërhyrje të jashtëzakonshme	6
3.1. Aktivitet e pranuar si kolateral për financim nga banka qendrore	7
3.2. Aktivitet që nuk janë të pranuar si kolateral për financim nga banka qendrore	7
4. Mobilizimi i kolateralit në ndërhyrje e jashtëzakonshme	8
4.1. Aktivitet e pranuar si kolateral për financim nga banka qendrore	9
4.1.1. Aktivitet e tregtueshme të pranuar	9
4.1.2. Aktivitet e patregtueshme të pranuar	10

1. Hyrje

1. Kapaciteti për të maksimizuar sasinë e kolateralit që mund të mobilizohet në ndërhyrjen e jashtëzakonshme është faktori kyç për të siguruar vazhdimësinë financiare të bankës në vështirësi. Në kohë krize, tregjet nuk besojnë në qëndrueshmërinë financiare të bankës dhe kërkojnë aktive si kolateral, për të krijuar siguri shtesë, përpara se të japin financim. Gjithashtu, kolaterali kërkohet për të aksesuar financimin e zakonshëm nga banka qendrore dhe për të lehtësuar sigurimin e financimit të jashtëzakonshëm².
2. Në momentin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, një pjesë e madhe e aktiveve likuide të bankës mund të jenë të barrësuara, prandaj aksesimi në financimin e kolateralizuar nëpërmjet tregjeve private, si dhe financimi i zakonshëm nga banka qendrore, mund të jenë të kufizuara. Një banke në ndërhyrje të jashtëzakonshme mund t'i kërkojë të mobilizojë aktive më pak likuide dhe me cilësi më të ulët, në mënyrë që të sigurojë fonde nga tregjet private, kundrejt financimit të zakonshëm nga banka qendrore dhe/ose nga Fondi për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme. Prandaj, identifikimi dhe mobilizimi i aktiveve të disponueshme si kolateral, në kohën e duhur, është një element kyç për të mbështetur vazhdimësinë financiare të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Megjithatë, ky kapacitet kërkon që banka të kuptojë qartë kërkesat ligjore dhe operacionale që duhet të respektojë, për të fituar akses në kredinë e kolateralizuar.
3. Sigurimi i mbështetjes me likuiditet nga Fondi për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme nuk është një proces automatik pasi kërkon një vendimmarrje të veçantë. Ky udhëzues nuk parashikon ndonjë vendim përkatës, në këtë drejtim. Ai synon të vlerësojë kapacitetin e bankave për të ofruar informacionin përkatës mbi klasat e aktiveve që mund të mobilizohen si kolateral në ndërhyrje të jashtëzakonshme, pavarësisht ofruesit të likuiditetit, përfshirë huadhënësit privatë.
4. Gjatë procesit të vlerësimit të rreziqeve në një bankë, Autoriteti Mbikëqyrës vlerëson nëse banka ka sasi të mjaftueshme të aktiveve likuide me cilësi të lartë (HQLA) për të përmbushur nevojat e saj për likuiditet si dhe kërkesat rregullatore, gjithashtu. Megjithatë, edhe pse vlerësimet mbikëqyrëse të administrimit të kolateralit të bankës janë një pikënisje e rëndësishme për planifikimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, ato nuk mund të zëvendësojnë vlerësimet e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për këto arsye:
 - (i) vlerësimet mbikëqyrëse kanë për qëllim të parandalojnë falimentimin e bankës, duke mbikëqyrur praktikën e kolateralit si dhe ekzistencën e rezervave të mjaftueshme të likuiditetit. Nga ana tjetër, planifikimi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme fillon nga supozimi i falimentimit të një banke. Në ndërhyrje të jashtëzakonshme, banka duhet të mobilizojë si kolateral klasa të ndryshme aktivesh, pasi ato më likuidet do të përdoren të parat, për të përballuar vështirësitë gjatë fazës së rimëkëmbjes. Kjo nënkupton përshtatjen e një qasjeje më të gjerë për menaxhimin e kolateralit, për të lehtësuar të gjitha opsionet e mundshme të financimit, duke përfshirë ngritjen e proceseve të ndryshme dhe zhvillimin e aftësive specifike të bankës;
 - (ii) vlerësimet mbikëqyrëse nuk marrin parasysh pasojat e zbatimit të skemës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme, për

² Për qëllime të këtij udhëzuesi, financim i jashtëzakonshëm nënkupton mbështetje me likuiditet nga Fondi për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme.

disponueshmërinë e kolateralit ose për ekzekutimin e operacioneve për menaxhimin e kolateralit në një bankë në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

5. Likuiditeti dhe financimi në ndërhyrje e jashtëzakonshme përbën një nga prioritetet e planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Ky udhëzues operacional plotëson më tej Aneksin 2 të rregullores nr.31/2018 “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, duke ofruar për bankat udhëzime shtesë mbi aftësitë dhe mbi produktet e kërkuara nga bankat në këtë Aneks.
6. Në përputhje me kërkesat në Aneksin 2, si më lart, banka pritet të krijojë procese dhe të zhvillojë aftësi për të identifikuar dhe mobilizuar kolateralin në ndërhyrje e jashtëzakonshme. Për të siguruar një shpërndarje efektive dhe efikase të kolateralit në ndërhyrje e jashtëzakonshme, banka duhet të jetë në gjendje të (i) përcaktojë kohën e nevojshme për të mobilizuar kolateralin e pranueshëm për operacionet e rfinansimit në tregjet private ose nëpërmjet bankës qendrore (ii) të parashikojë hapat e nevojshëm për ta bërë atë të pranuar për palët. Përveç analizës shteruese që bankat do të hartojnë për qëllime të përmbushjes së kërkesave të këtij udhëzuesi, bankat do të raportojnë dhe një format të përmbledhur të proceseve të mobilizimit të kolateralit, sipas tabelave të përfshira në Aneksin 2 të këtij udhëzuesi.
7. Në këtë kuadër, ky udhëzues është i strukturuar rreth tre objektivave të mëposhtëm:
 - a. të sigurojë që qeverisja dhe menaxhimi i kolateralit të bankës të mbështesë skemën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të kontribuojë në vazhdimësinë financiare të bankës/grupit (Seksioni 2);
 - b. të sigurojë që banka ka kapacitetet e nevojshme për të identifikuar kolateralin, duke përfshirë shumën, vendndodhjen, kuadrin ligjor të qeverisjes së tij, monedhën dhe disponueshmërinë e tij (Seksioni 3);
 - c. të vlerësojë kapacitetin e bankës për të mobilizuar kolateralin, dhe në veçanti aktivet e patregtueshme dhe aktivet që nuk kualifikohen për financim të zakonshëm nga banka qendrore (Seksioni 4).

2. Kuadri i qeverisjes dhe menaxhimit të kolateralit në ndërhyrjen e jashtëzakonshme

8. Kuadri i qeverisjes dhe menaxhimit të kolateralit të një banke i referohet politikave, proceseve dhe qeverisjes në lidhje me ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të kolateralit. Kuadri i kolateralit luan një rol kyç në ndërhyrje të jashtëzakonshme, pasi i mundëson bankës të ketë akses në likuiditet, duke siguruar kështu vazhdimësinë financiare.
9. Në këtë këndvështrim, banka pritet të ofrojë informacion për kuadrin e menaxhimit të kolateralit, për të siguruar që ky kuadër:
 - a. mund të mbështesë ekzekutimin e procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
 - b. mund t'i përshtatet rrethanave specifike të një skenari ndërhyrjeje të jashtëzakonshme;
 - c. nuk do të ndikohet negativisht nga asnjë masë e mundshme për ndarjen e subjekteve të grupit, në rastin e instrumenteve të transferimit.

2.1. Qeverisja dhe menaxhimi i kolateralit në ndërhyrje të jashtëzakonshme

10. Banka pritet të përshkruajë se si do të strukturohet qeverisja dhe menaxhimi i kolateralit në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe për këtë duhet të ofrojë informacionin e mëposhtëm:
 - a. detajet e kuadrit të qeverisjes dhe menaxhimit të kolateralit, duke përfshirë nivelin e centralizimit të funksionit të administrimit të kolateralit, organet vendimmarrëse brenda subjekteve të ndryshme të grupit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe njësitë kryesore të biznesit të përfshira në menaxhimin dhe monitorimin e kolateralit;
 - b. monitorimin e metrikave dhe të treguesve të paralajmërimit të hershëm të përdorur nga banka për rimëkëmbjen ose proces tjetër përshkallëzimi, duke përfshirë politikën e tyre të barrësimit të aktiveve, kapacitetin për të monitoruar barrësimin e aktiveve në nivel të subjekteve kryesore të likuiditetit, burimet kryesore të barrësimit dhe veprimet e identifikuar të menaxhimit që mund të çlirojnë kolateralin e barrësuar;
 - c. çdo ndryshim në proceset e rregullta të qeverisjes dhe menaxhimit të kolateralit të bankës, pas zbatimit të parashikuar të veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë çdo ndryshim të roleve dhe përgjegjësisë në njësi të ndryshme dhe organe vendimmarrëse (duke marrë parasysh ndarjen e mundshme të subjekteve për shkak të veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme). Kjo duhet të përfshijë çdo masë të përcaktuar, të identifikuar nga banka, për të adresuar çdo ndikim negativ në funksionin e menaxhimit të kolateralit dhe marrëveshjet e qeverisjes, pas zbatimit të strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2.2. Aksesi i bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme në financimin në kohë normale nga banka qendrore

11. Aksesi i bankës në financimin e zakonshëm nga banka qendrore përbën një rol të rëndësishëm në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Për këtë qëllim, është e nevojshme të kuptohet se si banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme do të ketë akses në financimin e zakonshëm nga banka qendrore, për të identifikuar çdo çështje që mund të ndikojë këtë akses, si rezultat i veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në mënyrë më specifike, banka duhet të dërgojë informacion për politikën se si do të aksesojë operacionet e zakonshme të financimit nga banka qendrore, burimet e financimit në kohë të vështirësisë financiare, duke përfshirë sinjalet e paralajmërimit të hershëm, procedurat e përshkallëzimit dhe instrumentet që do të përdoren.
12. Banka duhet të vlerësojë nëse zbatimi i veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme do të pengonte aksesin në financimin e zakonshëm nga banka qendrore. Në veçanti, banka duhet të vlerësojë nëse zbatimi i strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme do të ndikonte në kushtet e aksesit të financimit të zakonshëm nga banka qendrore, për shkak të ndikimit të mundshëm në strukturën e bankës ose për shkak të ndryshimeve në subjektet e grupit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, pas zbatimit të veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2.3. Aksesi i bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme në financimin e siguruar nëpërmjet tregjeve private

13. Banka duhet të përshkruajë strategjinë dhe politikën lidhur me aksesin në financimin e garantuar (*secured funding*) nëpërmjet tregjeve financiare private, d.m.th. me institucionet e tregut financiar. Si pikënisje, dhe duke marrë parasysh përdorimin e opsioneve të financimit të garantuar nëpërmjet tregjeve private në kontekstin e planit të rimëkëmbjes

dhe planit të kontigjencës për financimin, vlerësimi duhet të përshkruajë operacionet e financimit të garantuara (p.sh. *repo*-t, titullzimin, obligacionet e garantuara (kolateralizuara), etj..) dhe aftësinë e bankës për të gjeneruar fonde të garantuara (kolateralizuara) në vend të fondeve të pagantuara, duke u fokusuar në:

- a. subjektet që kryejnë veprimet, veçanërisht kur duhet të krijohen subjekte specifike për veprime përkatëse (p.sh. SPV);
- b. subjektet që ofrojnë kolateralin për garantimin e veprimit;
- c. nëse zbatimi i strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mund të pengonte disa prej këtyre veprimeve (p.sh. në rastet e strategjive të transferimit); dhe
- d. palët që do të ofrojnë financim në këto situata.

3. Identifikimi i aktiveve që do të përdoren si kolateral në ndërhyrje të jashtëzakonshme

14. Identifikimi i kolateralit duhet të kuptohet si kapaciteti për të ofruar informacion të detajuar mbi disponueshmërinë e kolateraleve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, në mënyrë të qartë dhe në kohë të shkurtër. Kjo do të thotë, që banka duhet të jetë në gjendje të identifikojë aspektet ligjore dhe disponueshmërinë operationale të secilës klasë të aktiveve përkatëse që mund të përdoret si kolateral përmes tregjeve financiare private, financimit nga banka qendrore, si dhe financimit të jashtëzakonshëm. Kjo përfshin minimalisht, kapacitetin për të identifikuar aktivet sipas tregtueshmërisë së tyre (i tregtueshëm/ i patregtueshëm), dhe sipas pranueshmërisë për financim nga banka qendrore (i pranuar/i papranuar).
15. Në bazë të nenit 11, pika b dhe c të rregullores nr.31/2018 “Mbi planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme duhet të pëmbajnë një përshkrim të burimeve të mundshme të financimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë termat/kushtet e financimit, kriteret për përdorimin e tij, kohën në të cilën është i disponueshëm, subjektet nga të cilat mund të përfitohet financim, kërkesat përkatëse për kolateral, si dhe një përshkrim dhe analizë të procesit se si dhe kur banka mund të aplikojë për përdorimin e instrumenteve financiare të Bankës së Shqipërisë, në kushtet e trajtuara në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë identifikimin e kolateralit përkatës.
16. Identifikimi i kolateralit të disponueshëm dhe i palëve të mundshme është një proces që kërkon kohë dhe që duhet të trajtohet përpara krizës. Banka pritët të ketë aftësinë e nevojshme për të identifikuar disponueshmërinë praktike, operationale dhe ligjore të kolateralit, veçanërisht për ato aktive që nuk mbulohen nga procesi mbikëqyrës dhe që mund të mobilizohen në rastet e financimit të jashtëzakonshëm. Duke patur parasysh shumëllojshmërinë e modeleve të biznesit dhe të kuadrit ligjor, është e vështirë të përcaktohet një listë shteruese e aktiveve që do të ishin të përshtatshme për ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Megjithatë, si pikënisje, aktivet duhet të jenë të kategorizuara sipas tregtueshmërisë dhe pranueshmërisë së tyre për të siguruar akses në financimin nga banka qendrore.
17. Banka duhet të realizojë një vlerësim të aftësisë për të identifikuar kolateralin që mund të përdoret për të siguruar fonde në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në veçanti, banka duhet:
 - a. të zhvillojë aftësitë për të identifikuar me saktësi të gjitha aktivet që mund të përdoren si kolateral në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet

- aktiveve me cilësi më të ulët dhe atyre më pak likuide si dhe, aktiveve që nuk kualifikohen për financim nga banka qendrore;
- b. të ketë aftësitë për të identifikuar vendndodhjen e kolateralit të disponueshëm brenda të gjitha subjekteve të grupit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
 - c. të ketë kapacitete të përshtatshme të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit (SMI) që i mundëson të vlerësojë, dokumentojë dhe monitorojë ecurinë e kolateralit në dispozicion, dhe të ofrojë rregullisht raporte të përditësuara.
18. Për më tepër, për aktivet e (pa) tregtueshme dhe/ose të (pa) pranuar, të cilat praktikisht mund të pranohen si kolateral për financimin përmes tregjeve private, nga banka qendrore, si dhe financimin e jashtëzakonshëm, banka duhet të ofrojë:
- a. vendndodhjen e aktiveve brenda grupit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë vendndodhjen fizike të kujdestarit (dhe agjentët e shlyerjes) ku mbahen aktivet, dhe subjektet e grupit në bilancin e të cilëve regjistrohen aktivet;
 - b. disponueshmërinë ligjore dhe praktike të aktivitetit (pa barrë), në nivel të subjekteve të rëndësishme të likuiditetit apo në nivel të grupit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;
 - c. nivelin e barrësimit sipas klasës së aktiveve;
 - d. ligjin qeverisës të aktiveve; dhe,
 - e. monedhën në të cilën janë të shprehura aktivet.

3.1. Aktivet e pranuar si kolateral për financim nga banka qendrore

19. Banka duhet të minimizojë sasinë e aktiveve, për të cilat është e paqartë pranueshmëria (kualifikimi) nga banka qendrore, duke identifikuar dhe ndërmarrë hapa për të sqaruar pranueshmërinë e tyre. Pamundësia për të vlerësuar pranueshmërinë e kolateralit, për shembull për shkak të cilësisë së të dhënave, nuk duhet të rezultojë në një klasifikim si “i papranueshëm” të kolateralit. Banka duhet të përshkruajë shkaqet rrënjësore të paftësisë për të vlerësuar pranueshmërinë e kolateralit dhe të paraqesë një plan për të korrigjuar këto shkaqe rrënjësore. Objekti i vlerësimit duhet të mbulojë ato aktive, të cilat praktikisht mund të mobilizohen për të siguruar financim nga banka qendrore.

3.2. Aktivet që nuk janë të pranuar si kolateral për financim nga banka qendrore

20. Angazhimi i bankës për identifikimin e aktiveve që nuk janë të pranuar për financim nga banka qendrore nxjerr në pah mungesën e kërkesave të detajuara të kuadrit të kolateralit për këtë qëllim. Megjithatë, kjo nuk e pengon bankën që në fazën e planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, të realizojë një punë paraprake për rritjen e mundësisë për shfrytëzimin e këtyre aktiveve në ndërhyrje të jashtëzakonshme.
21. Aktivet që nuk kualifikohen për financim nga banka qendrore mund të përdoren si kolateral për të siguruar fonde gjatë ndërhyrjes e jashtëzakonshme. Kjo klasë aktivesh mund të përdoret për të marrë fonde nëpërmjet tregjeve private. Për më tepër, në parim mund të pranohen si kolaterale ato aktive që nuk kualifikohen për financim nga banka qendrore, por mund të përdoren kur sigurohet likuiditet përmes Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Në këtë këndvështrim, banka pritët të zhvillojë aftësinë për të identifikuar aktivet e papërshtatshme për financim nga banka qendrore, p.sh. (në përputhje me klasat e aktiveve

të detajuara në Tabelën 1 më poshtë). Banka duhet të ketë mjetet dhe proceset e nevojshme për të ofruar një pasqyrë të zotërimeve të saj të paktën në nivel të klasës së aktiveve, dhe kjo përfshin:

- a. monedhën, vlerën e tregut (në monedhën vendase dhe euro) dhe vlerën e likuiditetit që mund të realizohet nëpërmjet financimit të garantuar për aktivet e tregtueshme;
- b. vlerën nominale ose kontabël për aktivet e patregtueshme.

Tabela 1. Identifikimi i aktiveve

I tregtueshëm			
Të pranuar për financim nga banka qendrore	PO	PO	JO
		• Letra me vlerë të garantuara nga aktivet (ABS)	• Depozitat me afat;
		• Obligacionet e qeverisë;	• Kreditë;
		• Obligacionet e garantuara (kolateralizuara);	• Instrumente borxhi të garantuara (të kolateralizuara) me hua hipotekore të individëve;
		• Obligacionet e korporatave;	• Instrumente borxhi të patregtueshëm të garantuar nga kreditë;
		• Obligacione bankare të paguarantuar (të pakolateralizuara);	• Të tjera.
		• Të tjera.	
	JO	• Letra me vlerë të garantuara nga aktivet (ABS)	• Kreditë;
		• Obligacionet e qeverisë;	• Instrumente borxhi të garantuara (të kolateralizuara) me hua hipotekore të individëve;
		• Obligacionet e garantuara;	• Pasuri të paluajtshme;
• Obligacionet e korporatave;		• Të tjera.	
• Të tjera.			

22. Për qëllime të përmbushjes së këtyre kërkesave, banka do të raportojë klasifikimin e aktiveve në bilanc, për tremujorin e dytë të vitit 2024, sipas tabelave të përfshira në Aneksin 1 të këtij udhëzuesi.

4. Mobilizimi i kolateralit në ndërhyrje të jashtëzakonshme

23. Mobilizimi i kolateralit në ndërhyrje e jashtëzakonshme i referohet grupit të veprimeve kontigjente që ndërmerren nga banka për të aksesuar financim të kolateralizuar për të mbështetur vazhdimësinë e saj financiare gjatë gjithë procesit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Mobilizimi i kolateralit përfshin procese të ndryshme në varësi të llojit të transaksionit financues (p.sh. repo-t, huadhënie/huamarrje të letrave me vlerë, etj.), klasës së aktiveve që përdoren si kolateral (p.sh. aktive të tregtueshme, të patregtueshme) dhe kuadrit ligjor të qeverisjes së tyre. Për këto arsye, banka mund të zhvillojë aftësinë e saj bazuar në modelin e biznesit dhe strukturën përkatëse të financimit. Duke pasur

parasysh se aktivet e pranuara si kolateral, mund të jenë të kufizuara ose të barrësuara në kohën kur një bankë hyn në ndërhyrje të jashtëzakonshme, banka duhet të vlerësojë burimet shtesë të likuiditetit, si p.sh. nëpërmjet mobilizimit të aktiveve të patregtueshme, por të pranuara nga ana e bankës qendrore, dhe aktiveve, të cilat nuk janë të pranuara për financim nga banka qendrore.

24. Objektivi i përgjithshëm është që banka të ketë aftësinë e nevojshme për të maksimizuar shumën e financimit të garantuar/kolateralizuar, që mund të aksesojë në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në veçanti, kjo i referohet kapacitetit operacional të një banke për të mobilizuar klasa të ndryshme kolaterali, duke respektuar kërkesat ligjore për ta vënë atë në dispozicion të palëve të ndryshme. Banka duhet të zhvillojë dhe përshkruajë kapacitetin e saj për të mobilizuar aktive të ndryshme si kolateral (d.m.th. të pranuara ose jo për financim nga banka qendrore, aktive të tregtueshme ose të patregtueshme). Banka duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë kapacitetit për të mobilizuar aktivet e patregtueshme, por të pranuara për financim nga banka qendrore, ose aktivet e papranuara nga banka qendrore, të tregtueshme dhe të patregtueshme.
25. Banka pritët të kryejë një vlerësim për secilin nga dimensionet e mëposhtme dhe minimalisht për secilën nga klasat e aktiveve të përcaktuara në Tabelën 1, më sipër, për:
 - a. kapacitetin e bankës për të identifikuar çdo pengesë ligjore dhe operationale për mobilizimin e kolateralit në nivel lokal dhe ndërkombëtar.
 - b. kapacitetin e bankës për të identifikuar palët (private) nga mund të sigurohet financim i kolateralizuar në ndërhyrje e jashtëzakonshme.
 - c. kapacitetin e bankës për të identifikuar kohën që do t'i duhej për të mobilizuar kolateralin për të aksesuar financim të garantuar (kolateralizuar), duke përfshirë hapat e nevojshëm operationalë (p.sh. koha për të hartuar kontratat, për të zbatuar transaksionet në sistemet e TI, etj.).
26. Banka duhet të zhvillojë dhe dokumentojë hapat operationalë (me horizontet e tyre kohore) për mobilizimin e këtyre klasave të aktiveve, duke përshkruar, gjithashtu, se si mund të mobilizohen këto aktive (p.sh., ndër të tjera, nëpërmjet shitjes, marrëveshjeve të riblerjes (repo) ose instrumenteve të bankës qendrore). Në mënyrë të ngjashme, banka pritët të identifikojë pengesat e mundshme operationale, rregullatore dhe ligjore (p.sh. aftësi të kufizuara të SMI), të cilat do të kufizonin ose ndalonin mobilizimin e aktiveve specifike në ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke parashikuar dhe masat e mundshme lehtësuese.

4.1. Aktivet e pranuara si kolateral për financim nga banka qendrore

27. Financimi nëpërmjet instrumenteve të bankës qendrore, për bankën në ndërhyrje e jashtëzakonshme, ka avantazhin e mbështetjes në një infrastrukturë ekzistuese për mobilizimin e kolateralit, si dhe në procese standarde që janë të njohura për bankën. Megjithatë, më së shumti, në ndërhyrje e jashtëzakonshme, aktivet likuide të pranuara mund të jenë të kufizuara, pasi ato mund të jenë përdorur në fazën e rimëkëmbjes.

4.1.1. Aktivet e tregtueshme të pranuara

28. Në rastet e ndërhyrjes e jashtëzakonshme, aktivet e tregtueshme të pranuar si kolateral nga banka qendrore janë burimi më efikas i financimit të kolateralizuar, duke pasur parasysh cilësinë e lartë të kolateralit dhe infrastrukturën tashmë të vendosur për të lehtësuar mobilizimin e tyre. Megjithatë, kur një bankë hyn në ndërhyrje të jashtëzakonshme, kjo klasë aktivesh ka të ngjarë të jetë e kufizuar, pasi ajo mund të jetë përdorur nga banka, gjatë fazës së rimëkëmbjes.

4.1.2. Aktivet e patregtueshme të pranuar

29. Kapaciteti për të mobilizuar aktive të patregtueshme (por që mund të jenë të pranuar si kolateral nga banka qendrore) (p.sh. kredia, instrumente të borxhit të garantuar nga kreditë, instrumente borxhi të mbështetur nga kreditë hipotekore të individëve, etj.) duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të thelluar për qëllime të planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Këto aktive mund të përfaqësojnë një burim të rëndësishëm likuiditeti në ndërhyrje të jashtëzakonshme kryesisht për dy arsye: (i) kanë një nivel të lartë probabiliteti për të qenë të pabarrësuar në kohën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme; dhe (ii) ka të ngjarë të përfaqësojnë shumicën e aktiveve (veçanërisht pretendimet e kredisë) të bankës në momentin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.